



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 12/08/2021 Ref.: 3036/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditoohen programet e studimit të Kolegjit “Universum”, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
- Shkenca Politike, BA, 180 ECTS, maksimumi 150 studentë për vit akademik.
 - Gjuhë Angleze, me specializime: 1. Anglisht për Biznes dhe Media dhe 2. Anglisht me Gjermanisht, BA, 180 ECTS, maksimumi 150 studentë për vit akademik.
 - Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS, maksimumi 250 studentë për vit akademik.
- II. Akreditoohen programet e studimit të Kolegjit “Universum”, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
- Higjienë Dentare, BA Profesional, 180 ECTS, maksimumi 65 studentë për vit akademik.
 - Fizioterapi, BA Profesional, 180 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik.
 - Dizajn Grafik, BA, 180 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik.
 - Siguri Kibernetike, BA Profesional, 180 ECTS, maksimumi 70 studentë për vit akademik.
 - Gazetari Digjitale, BA Profesional, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik.
 - Juridik, LLB, 240 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik.
 - Shkenca Politike, me specializim në Administratë Publike, BA, 180 ECTS, dega në Ferizaj, maksimumi 80 studentë për vit akademik.

III. Akreditohe programet e studimit të Kolegjit “Universum”, për periudhën dy vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2023:

- Infermieri, BA, 180 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik.
- Shkenca e të Dhënave, MSc, 120 ECTS, maksimumi 75 studentë për vit akademik.

IV. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.

V. Obligohet Kolegji “Universum” që deri më datën 15.11.2021 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.

VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Kolegji “Universum” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1	Shkenca Politike, BA, 180 ECTS Ri akreditim	Samet Dalipi Fadil Berisha Shpreca Kaciku
2	Gjuhe Angleze, me specializime: 1. Anglisht për Biznes dhe media dhe 2. Anglisht me Gjermanisht, BA, 180 ECTS Ri akreditim	Mejreme Ymeri Ismail Aliu Arsim Rexhepi Mirjan Zeneli Artan Limani Jusuf Mustafai
3	Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS Ri akreditim	Arianit Krypa Agron Bislimi Ardian Gojani Mandeep Chaudhary
4	Higjienë Dentare, BA Profesional, 180 ECTS Akreditim	Genc Qilerxhiu Migjen Demjaha Arianit Emra Albert Sylja Astrit Sokoli
5	Fizioterapi, BA Profesional, 180 ECTS Akreditim	Djellza Zeka Rexha Bekim Ramabaja Kaltrina Abazi Blerton Hulaj
6	Dizajn Grafik, BA, 180 ECTS	Bora Kelmendi Nevila Muka

		Hana Bakalli Drenusha Zeka Arben Grajqevci
7	Siguri Kibernetike, BA Profesional, 180 ECTS	Xhemile Morina Rrezart Prebreza Durim Gjoshi Besiana Zeka Valerina Smakaj
8	Gazetari Digjitale, BA Profesional, 180 ECTS	Arbenita Hoxha Naser Thaçi Afet Bela Venera Radoni Sami Shala
9	Juridik, LLB, 240 ECTS	Jetmire Zeqiri Edib Abazi Hebib Livoreka Alban Maliqi
10	Shkenca Politike, me specializim në Administratë Publike, BA, 180 ECTS, dega në Ferizaj	Nexhmedin Bardhi Bilal Lutfiu Nijazi Halili
11	Infermieri, BSc, 180 ECTS	Fatjona Gërzhaliu Zana Shabani Flaka Shoshi Tevide Bllaca
12	Shkenca e të Dhënave, MSc, 120 ECTS	Lavdim Halilaj Shqipe Buzuku

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin “Universum”, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizitat janë organizuar më 30.03.2021, 22.04.2021 dhe 27.04.2021, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Damir Kalpić, Diana Milčić, Adrian Stan, Mikus Dubickis, Vlatko Cvrtila, Danica Železnik, Delia Gologan, Goce Naumovski, Frank Baasner dhe Majda Tafra-Vlahović.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit, dhe për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit Shkenca Politike, BA, 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2), substancialisht pesë (5).
2. Për programin e studimit Gjuhe Angleze, me specializime: 1. Anglisht për Biznes dhe media dhe 2. Anglisht me Gjermanisht, BA, 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht gjashtë (6) dhe substancialisht një (1).
3. Për programin e studimit Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1) dhe substancialisht gjashtë (6).
4. Për programin e studimit Higjienë Dentare, BA Profesional, 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht pesë (5) dhe pjesërisht një (1).


5. Për programin e studimit Fizioterapi, BA Profesional, 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht shtatë (7).
6. Për programin e studimit Dizajn Grafik, BA, 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht pesë (5) dhe pjesërisht dy (2).
7. Për programin e studimit Siguri Kibernetike, BA Profesional, 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht pesë (5), pjesërisht një (1).
8. Për programin e studimit Gazetari Digjitale, BA Profesional, 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht shtatë (7).
9. Për programin e studimit Juridik, LLB, 240 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht katër (4) dhe pjesërisht dy (2).
10. Për programin e studimit Shkenca Politike, Shkenca Politike, me specializim në Administratë Publike, BA, 180 ECTS, dega në Ferizaj, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2) dhe substancialisht pesë (5).
11. Për programin e studimit Infermieri, BA, 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program i përmbush: substancialisht katër (4) dhe pjesërisht tri (3).
12. Për programin e studimit Shkenca e të Dhënave, MSc, 120 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program i përmbush: substancialisht katër (4) dhe pjesërisht dy (2).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07. 07. 2021 dhe 27.07.2021 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit “Universum” dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit “Universum”;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

